



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 07.06.2017]

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Alb Tiefbau” shpk (60%) dhe “Pe Vla Ku” shpk (40%)

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rikonstruksion i rruges se Velipojes segmenti Harku i Berdices - Baks ” Lot. 3.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rruges se Velipojes segmenti Harku i Berdices - Baks ” Lot. 3.**

Kohëzgjatja: brënda 18 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 886.349.000 (teteqind e tetedhjetë e gjashtë milion e treqind e dyzet e nente mije) Lekë pa TVSH. Fondi i akorduar për vitin 2017 është 177.269.973 Lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 15.05.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	VELLEZERIT HYSA	609,971,301
2	ALBA KONSTRUKSION	615,579,248
3	GENER 2	620,073,714
4	CURRI	641,903,073
5	ALB TIEFBAU	726,804,422
6	ALKO IMPEX	749,832,317
7	GJOKA KONSTRUKSION	776,126,447
8	ADEM POJANI	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Vellezerit Hysa” shpk (85%) dhe “Ergi” shpk (15%) pasi:

Shoqeria “Vellezerit Hysa” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.10 per kualifikim (deklarimin e puneve ne proces) pasi ne daten 03.05.2017 eshte shpallur fitues i kontrates “Pastrimi kanaleve kullues, ne territorin e Bashkise Rrogozhine” me vlere 9.549.327 leke me tvsh, lidhur me Bashkine Rrogozhine, sipas njoftimit te fituesit te botuar ne Buletinin 19, te dates 15.05.2017. Kete objekt nuk e ka deklaruar ne formular, ndonese data e tenderit ka qene 14.05.2017.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paguar taksat per vitin 2017 ne Tirane (Berzhite) ku ka kryer aktivitet nga data 12.04.2016 deri ne daten 16 mars 2017. Edhe deklarata e paraqitur per te plotesuar kerkesen 2.2.5 per kualifikim rezulton e pa vertete.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut pasi kontrata me mjekun eshte lidhur ne daten 01.02.2017 e, ne kete menyre, nuk figuron ne listepagesen e janarit, ne perputhje me kërkesen per kualifikim.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve te nevojshme teknike per realizimin e kontrates, pasi ka marre persiper punime betoni dhe referuar formularit te deklarimit te mjeteve nuk ka impiant betoni, autobot uji, autobetoniere (ka vetem 1 betoniere 0.25 m3), pompe betoni. Pa keto mjete nuk mund te siguroje ndertimin e strukturave ne perputhje me kushtet teknike.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.10 per kualifikim (deklarimin e puneve ne proces) pasi:

- Ne daten 20.04.2017 ka lidhur kontraten me vlere 26.701.149 leke me tvsh, lidhur me Bashkine Gramsh (si antar i JV), sipas njoftimit te botuar ne Buletinin 19, te dates 15.05.2017. Kete objekt nuk e ka deklaruar ne formular, ndonese data e tenderit ka qene 14.05.2017.
- Ne daten 08.05.2017 ka lidhur kontraten me vlere 19.147.908 leke me tvsh, lidhur me Ujesjelles Kanalizime sha Tirane, sipas njoftimit te botuar ne Buletinin 19, te dates 15.05.2017. Kete objekt nuk e ka deklaruar ne formular, ndonese data e tenderit ka qene 14.05.2017.

2. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Alba Konstruksion” shpk pasi:

Nuk ploteson kërkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi per te plotesuar kriterin ka deklaruar realizimin e puneve te meposhtme:

- “Rruga Rreshen Urake”. Per kete pune jane paraqitur faturat tatimore te cilat jane te viteve 2011 – 2013 dhe nuk rezulton qe te kete pune te kryer gjate tre viteve te fundit.
- “Unaza e re Tirane”. Per kete object te realizuar si JV me Karl Gega Konstruksion nuk jane paraqitur faturat tatimore qe ka leshuar shoqeria “Alba Konstruksion” shpk, por vetem ato qe shoqeria “Karl Gega Konstruksion” e ka leshuar autoritetit kontraktor. Duke qene se mungojne faturat tatimore ky object nuk mund te merret ne konsiderate.
- “Godine banimi dhe sherbimi Farke”. Vlera pa tvsh e puneve te kryera gjate tre viteve te fundit ne kete object nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk, referuar faturave tatimore, eshte 26.543.780 leke. Ky object nuk mund te konsiderohet si object I ngjashem.
- “Rruga Lushnje”. Vlera pa tvsh e puneve te kryera gjate tre viteve te fundit ne kete object nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk, referuar faturave tatimore, eshte 203.209.922 leke.
- “Rruga Urake – Ura e Shoshajve”. Vlera pa tvsh e puneve te kryera gjate tre viteve te fundit ne kete object nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk, referuar faturave tatimore, eshte 323.414.421 leke. Vlerat u moren nga faturat tatimore qe shoqeria “Impresa” spa I ka leshuar autoritetit kontraktor, pasi faturat e leshuara nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk jane te pa lexueshme.
- “Rikualifikim urban i dy shesheve ne Tirane”. Vlera pa tvsh e puneve te kryera gjate tre viteve te fundit ne kete object nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk eshte 56.485.985 leke.

Vlera e plote e puneve te realizuara ne tre vitet e fundit nga kjo shoqeri, referuar dokumentacionit te paraqitur, eshte 583.110.328 leke pa tvsh, ndersa vlera me e madhe e realizuar gjate tre viteve te fundit ne nje object te vetem eshte 323.414.421 leke pa tvsh. Kjo shoqeri duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje objekti te vetem te ngjashem me vlere jo me pak se 443.174.500 leke pa tvsh ose te shume puneve te ngjashme me vlere te pergjithshme jo me pak se

1.772.698.000 leke pa tvsh. Me dokumentacionin e paraqitur kjo shoqeri nuk ploteson asnje prej kushteve.

Nuk ploteson kërkesen 2.3.3 për kualifikim lidhur me punësimin e inxhinierëve, pasi pjesë nga stafi i deklaruar në këtë procedurë është i angazhuar në kontratën “Rikualifikim urban i Bashkisë Pukë”, për të cilën ky operator ekonomik është shpallur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Nuk ploteson kërkesen 2.3.4 për kualifikim lidhur me deklarinë për mosangazhimin e stafit, pasi deklarimi nuk është në përputhje me kërkesen. Në deklaratë shoqëria nuk shprehët se “inxhinierët janë të pa angazhuar”, por “stafi nuk do të jetë i angazhuar në kontratë të tjera”, deklarata që është e ndryshme nga kërkesa.

3. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Gener 2” shpk pasi:

Nuk ploteson kërkesen 2.d të Kërkesave të Vecanta për kualifikim pasi Formulari i Vlerësimit i paraqitur nuk është në përputhje me Formularin 8 të miratuar në DST, Formulari i paraqitur nuk përmban vlerën e objektit.

Nuk ploteson kërkesen 2.2.5 për kualifikim lidhur me deklaratën për taksat vendore pasi në deklaratën e paraqitur nuk është shprehur sipas kërkesës se “*ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017*”.

Nuk ploteson kërkesen 2.3.1 për kualifikim lidhur me punët e ngjashme pasi Formulari i Vlerësimit i paraqitur nuk është në përputhje me Formularin 8 të miratuar në DST, Formulari i paraqitur nuk përmban vlerën e objektit.

Nuk ploteson kërkesen 2.3.3 për kualifikim lidhur me punësimin e inxhinierëve, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për punësimin e një inxhinieri gjeolog, në përputhje me kërkesen.

Gjithashtu inxhinieri i ndërtimit Ramadan Bumci, inxhinieri hidroteknik Alfred Lako, inxhinieri elektrik Arqile Basho dhe inxhinierja e mjedisit Keida Muco, të deklaruar në tender si të pa angazhuar në kontratë të tjera, janë aktualisht të angazhuar në kontratën me objekt: “Construction of Vlora ring road lot 2 and rehabilitation of the public areas in front of the Vlora waterfront promenade road” për të cilën shoqëria “Gener 2” shpk është shpallur fituese në datën 3 Maj 2017.

Nuk ploteson kërkesen 2.3.4 për kualifikim lidhur me deklaratën për mosangazhimin e inxhinierëve, pasi në deklaratën e paraqitur nuk shprehët sipas kërkesës “*inxhinierët e kerkuar në piken 2.3.3 për kualifikim janë të pa angazhuar në kontratë të tjera*”.

4. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Curri” shpk (81.88%) dhe “Be-Is” shpk (18.12%) pasi:

Shoqëria “Curri” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.3 për kualifikim lidhur me punësimin e inxhinierëve, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për punësimin e inxhinierëve të kerkuar. Të gjithë inxhinierët e deklaruar në deklaratën për stafin (paraqitur nga shoqëria “Curri” shpk) janë të punësuar nga shoqëria “Be-Is” shpk e cila ka marrë persipër të kryejë vetëm 18.12% të punimeve.

Shoqëria “Curri” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.7 për kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve të nevojshme teknike për realizimin e kontratës, pasi ka marrë persipër punime për të gjithë zërat e parashikuar në preventivin e punimeve dhe, referuar formularit të deklaramit të mjeteve, nuk ka paraqitur dokumentacion për disponimin e një greideri, gurëthyes, frontoje, implant automatik betoni, autobitumatriçe, pompe betoni, mjet autovinç, sonde cpimi me diametër ≥ 1.2 në thellesi deri 20ml, vinc me kapacitet deri 30 ton. Këto mjete janë të domosdoshëm për realizimin e punimeve që ka marrë persipër.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

5. Te skualifikoje shogerine “Alko Impex General Construcion” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve:

- “Ndertimi i rruges tranzite per shale”, realizuar ne vitet 2011 – 2015, me vlere te realizuar ne tre vitet e fundit (ne perputhje me kerkesen per kualifikim) 234.273.280 leke pa tvsh.
- “Sistemim asfaltim i rruges “Qemal Stafa” Elbasan, realizuar ne vitet 2014 – 2015, me vlere te plote 57.330.164 leke me tvsh, me vlere te realizuar nga “Alko Impex” shpk 24.365.320 leke pa tvsh.
- “Sistemim asfaltim rruge Librazhd”, realizuar ne vitet 2015 – 2016, me vlere te plote 78.662.721 leke pa tvsh, me vlere te realizuar nga “Alko Impex” shpk 58.997.041 leke pa tvsh.

Vlera e plote (pa tvsh) e punimeve te kryera ne tre vitet e fundit per objektet e mesiperm eshte 317.635.640 leke pa tvsh. Ne kete menyre nuk ploteson kushtin per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 443.174.500 leke pa tvsh dhe as kushtin per realizimin e disa puneve me vlere jo me pak se 1.772.698.000 leke pa tvsh.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

6. Te skualifikoje shogerine “Adem Pojani” shpk per arsye se nuk ka paraqitur oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Alb Tiefbau” shpk (60%) dhe “Pe Vla Ku” shpk (40%)** se oferta e paraqitur, me vlerë 726.804.422 (shtatëqind e njezet e gjashte million e teteqind e kater mije e katerqind e njezet e dy) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **30.05.2017**.

Ankesa nuk ka patur. Afatet e ankimimit kane perfunduar.